



REPUBLIKA E SHqipëRIE
**MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORE**

PROJEKT: KËRKIM NË FERMË

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Titulli i projektit: “Teknikat te mbrojtjes nga miza e ullirit (B. Oleae) ne Cv. Kokërr Madh i Beratit.”.

Afati i zbatimit : viti 2013

**Drejtues i projektit
Mendim Bacaj
Ramo Merkohitaj**

**TITULLARI
Dr. Aulona Veizi**

Hyrje, Justifikimi i kërimit, vendi, stafi pjesëmarrës i kërkuesve dhe ekstensionistëve etj.

Miza e ullirit përfaqson dëmtuesin kryesor të kësaj kulture. Përhapja dhe shkalla e dëmit të këtij insekti nuk është homogjene në të gjithë zonat e kultivimit të ullirit. Numuri me i lartë i breznive dhe dëmtimet më të mëdha vërehen në zonën bregdetare. Në zonat e brendshme të kultivimit të ullirit, dëmtimet të konsiderueshme të këtij dëmtuesi konstatohen vetëm në vite të vecanta. Monitorimet e vazhdueshme dhe ndjekja e niveleve të infeksionit janë vendimtare për të përcaktuar momentet më të përshtatshme për ndërhyrje dhe mbajtjen në nivele të pranueshme nga ky dëmtues. Ulliri Kokërr Madh i Beratit konsiderohet si më i miri për tavolinë, por ai tërhiqet shumë nga miza e ullirit (B. Oleae) duke shkatëruar rënie të ndjeshme të prodhimit por edhe ulje të cilësisë dhe vlerave tregëtare të tij.

VENDI I ZBATIMIT. D.R.B.U.M.K. Berat - Komuna Bilçë - Fshati Dushnik.
Personat përgjegjës: Nga QTTB-ja: Mendim Bacaj, Ramo Merkohitaj
Shërbimi Këshillimor: Ekstensionisti Ajet Hyka, fermeri Agim Dushniku.

2. Objektivi i kërimit

Objektivi kryesor i studimit është: Përcaktimi i afatit të ndërhyrjes dhe teknikave optimale që përdoren në kontrollin e Mizës së ullirit të cv. K.M. Berat

3. Metodatat dhe materialet e përdorura: skema e eksperimentit, trajtimet, inputet, metodologjia etj.

Zhvillimi i kulturave drufrutore si dhe ai i ullishtarisë në vecanti, përbën sot një nga prioritetet në politikat e prodhimit bujqësor. Në këtë kuadër aplikimi i metodave bashkëkohore, eksperimentimi i hallkave të veçanta në agroteknikën e pa zbatuar deri tani, ku futet edhe mbrojtja e ullirit në kultivarin K.M. Berati, do të japë impaktet e veta në realizimin e prodhimeve të larta e cilësore.

Provat do të ngrihen në fshatin Dushnik të komunës Bilçë (Berat) në kultivarin K.M.-Berati (destinacion për tavolinë) me moshe mbi 10 vjeçare, në një fermë me fermer z. Agim Dushniku. Do të ngrihen në studim dy prova:


Prova e parë: Spërkatje (preventivë) me preparatin Succes 0.24 CB (përmbajtja Spinosad 0.24 gr./liter) Trajtimet fillojnë me konstatimin e çmimeve të para në kokërr e përsëriten çdo 21 ditë.

Prova e dytë: Spërkatje (kurative) të gjithë kurorës me preparatin Dimethoat (Rogor) Trajtimet fillojnë kur vërehet prezenca e çmimeve të para ose kur gjenden 2-3 femra /Kurth. Do të bëhen dy trajtime në intervalin 21 ditë nga njëra tjetra.

V.O. Cdo provë do të përbëhet me nga 30 pemë ulliri të cilat do të sigurohen në një fermë ose me shumë. Për të gjithë provat do të aplikohet e njëjta agroteknikë e cila do të rregjistrohet sipas proceseve të kryera dhe kohës së zbatimit të tyre, me përjashtim të trajtimeve kimike.

Monitorimi i dëmtuesit do të bëhet me anë të kurtheve të cilat do të vendosen në pemë nga mesi i muajit Maj dhe kontrolli i tyre për numerimin e mizave të rena do të bëhet një herë në javë e do të shënohen në një fletore. Kurthet me ngjyrë të verdhë ose në ato me ferromone vendosen në pemët e ullirit në lartësinë e mesit të kurorës, duke përdorur

normalisht 4-6 kurthe për hektar. Nderhyrja me trajtimet bëhet kur janë kapur 2-3 femra për kurth në javë, kjo vlen për trajtimet adulticide. Për trajtimet larvicide, metoda më praktike është përcaktimi i përqindjes të infeksionit aktiv në 100 kokrra.



Data e kontrollit	Ngracka e parë	Ngracka e dytë	Shënime
25.06.2013	0	0	
02.07.2013	0	0	
09.07.2013	0	0	
16.07.2013	0	0	
23.07.2013	1	0	
30.07.2013	0	0	
07.08.2013	1	1	
14.08.2013	1	1	
21.08.2013	2	1	
28.08.2013	3	2	Spërkatje me Rogor 0.2%-para
05.09.2013	3	2	
12.09.2013	4	3	
19.09.2013	3	5	Spërkatje me Rogor 0.2%-dyta
26.09.2013	5	4	

Monitorimi i mizës së ullirit (Berat-2013).

4-Rezultatet: përshkrimi i rezultateve (të dhëna dhe vrojtime) dhe rezultatet e analizës statistikore.

Mbështetur në metodikën e hartuar, rezultatet e studimit jepen nëpërmjet treguesve të marë, paraqitur në tabelën e mëposhtëme.

Tab.1. Përmbledhëse e treguesve kryesore.

Kontrolli për verifikimin e çpimeve të para në kokërr –Prova e parë

Data	L.	P.	K.p.	G.b.	% infeks	L.	P.	K.p.	G.b.	% infeks
15.09.2013	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0
25.09.2013	2	1	0	0	3	1	0	0	0	1
05.10.2013	3	2	0	0	5	3	0	0	0	3
15.10.2013	2	2	1	0	5	1	2	0	0	3
25.10.2013	4	2	1	1	8	2	2	0	0	4

V.O. Spërkatjet preventivuese janë realizuar sipas metodikës, me preparatin Success 0.24 CB, i cili është një përzierje komplekse me efekt tërhiq dhe “tërhiq dhe vrit”, për luftimin e mizës së ullirit. Në bazë të tij qëndron Spinmosadi një lëndë aktive

Data e kontrollit	Çpimet në 100/ kokrra		Shënime
	Nr. kokrrave	Nr. çpimeve	
Prova 1			
23.06.2013	100	0	
30.06.2013	100	0	
07.07.2013	100	0	
14.07.2013	100	0	
21.07.2013	100	2	
28.07.2013	100	5	Trajtimi parë me Sukses 0.24 CB

insekticide e re e ekstruar nga kolonitë bakteriale të *Saccharopolyspora spinoza*, një bakter që gjendet i pranishëm në natyrë. Një litër Success 0.24 CB hidhet në 30 litra ujë dhe me 300 gr. Solucion spërkatet çdo bimë me një metër katror, gjithmonë nga ana e lindjes. Trajtimet fillojnë mbi bazën e vrojtimit kur konstatohen çpimet e para nga miza e ullirit dhe përsëriten çdo 21 ditë duke kryer deri në 5 trajtime për çdo sezon.

Dinamika e fluturimit të mizës së ullirit-Berat 2013.

Çpimet e para u konstatuan në datën 21.07.2013, ndërsa fluturat e para të rëna në kurth U kapën në 07.08.2013. Spërkatja e parë në të gjithë kurorën me preparation Rogor në dozën 0.2% u krye në datën 28.02.2013. Ndërsa spërkatja e dytë u bë në datën 19.09.2013.

Analiza e infeksionit në kokërr në dy prova.

05.11.2013	5	5	1	3	14	3	2	1	2	8
15.11.2013	8	4	3	2	17	4	3	2	3	12
25.11.2013	9	6	10	4	29	6	2	3	4	15

Success 0.24 CB

Rogor (Dimethoat) 0.2%

Legjenda: L-larvë, P-pupë, K.p.-këllëf pupe, G.b.- galeri boshe.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërmë konstatohet se në provën e parë ku është përdorur preparati Success 0.24 CB, infeksioni total në krahasim me infeksionin e provës me Rogor 0.2% është gati dy herë më i lartë. Kjo tregon se trajtimet e bëra me insekticidin Rogor janë më të efektshme, por nga ana tjetër ndotjet nga gjurmët e këtij preparati padyshim(sipas analizave dhe studimeve të bëra nga autore të ndryshëm) janë të larta duke ulur kështu sigurinë ushqimore të ullirit kokerr.

Vlerësimi i rezultateve: opinionet e fermerëve dhe ekstensionisteve.

Futja e metodave të reja në kontrollin e mizës së ullirit te K.M. Beratit përbën padyshim një sukses për të siguruar një produkt më të mirë sasior dhe cilësor. Përcaktimi i momentit për nderhyrjet kimike duke përdorur metoda bashkëkohore (ferromone + kapsulën tërheqëse), krijon siguri në efektivitetin e këtyre spërkatjeve. Të dy preparatet e përdorura në provë dhanë efektivitet shumë të mirë përse i përket ruajtjes së prodhimit nga infeksionet e mizës të ullirit deri në momentin e vjeljes.

6. Vlerësimi ekonomik: llogaritja e shpenzimeve dhe të ardhurave.

Vlerësimi ekonomik është bërë bazuar në të ardhurat për çdo, për çdo prove.

Tabela 6. Efektiviteti ekonomik.

Provat	Rendimenti kg./bime	Çmimi i shitjes (lek/kg.)	Tëardhura (lek)	Shpenzimet (lek)	Fitimi
Prova 1	20	80	48000	18460	29540
Prova 2	23	80	55200	17810	37390

7. Diskutime dhe konkluzione: diskutimi i rezultateve, aplikimi i përgjithshëm i tyre konkluzione teknike dhe ekonomike.

Në tabelën e efektivitetit ekonomik jepen qartë rezultatet e arritura përse i përket prodhimit dhe fitimit për çdo provë. Në provën e dytë me përdorimin e preparatit Rogor konstatohet se realizohet një prodhim më i lartë por edhe një e fitim më i mirë. Kjo vërteton atë që në rastet kur për mbrojtjen e ullirit nga miza e ullirit përdoret Rogori me trajtim të gjithë kurorës, sigurohet një mbulim më i mirë i të gjithë masës vegetative ku perfshihen edhe kokrrat e për pasojë mundësia e prekjes është më e ulët. Nga ana tjetër përdorimi i këtij preparati ul sigurinë ushqimore të kokrrave të ullirit i cili do të përdoret për tavolinë, shkatëron faunën e dobishme (parazitët biologjikë) e cila mban në mënyrë natyrale të ulët nivelin e infeksionit. Krejt e kundërta ndodh me preparatin Success 0.24CB i cili është një produkt biologjik.

8. Mesazhet e ekstensionit (Rekomandime).

Mbështetur në analizën e rezultateve dhe konkluzionet e dala rekomandojmë :

Të aplikohet në vazhdimësi monitorimi me ferromone i mizës së ullirit për të përcaktuar afatet më optimale të ndërhyrjeve kimike. Përdorimi i eshëve proteinike të hidrolizuara në kontrollin e mizës të ullirit, duhet të marri përhapje të gjërë pasi ka avantazhe në drejtim të uljes të shpenzimeve (spërkatet vetëm 1 metër katror nga ana e lindjes), mbron parazitët biologjikë të mizës së ullirit dhe nuk ngelen mbetje pesticide në produkt.

9. Përhapja (propagandimi) i rezultateve.

Aplikimi i kombinimit të spërkatjes me monitorimi e mizës së ullirit dhe futja në një masë më të madhe e përdorimit të eshkave proteinike, duhet parë në aspektin e kërkesave gjithnjë në rritje të konsumatorit për cilësi të ullirit kokërr për tavolinë, ndërkohë që do të ishte edhe një përgjigje e përballimit të konkurrencës në treg. Fermerët që kultivojnë ullinj për tavolinë duhet të jenë të vemëndshëm ndaj cilësisë së prodhimit pasi një cilësi e mirë do të jetë e sukseshme në treg.

Si formë rezultative e përhapjes së kësaj eksperience, do të ishte planifikimi i demonstrimit të ketij rezultati me fermerë kultivues të ullinjve. Demonstrimi mund të organizohet edhe në shkallë qarku me fermerë të zonës ose dhe më gjerë. Krahas demonstrimit praktik, me interes do të jetë shpërndarja e fletëpalosjes, fermerëve që kultivojnë ulli K.M. Berati, përgatitur nga stafi i projektit.

10. BUXHETI – (I detajuar sipas zërave të 602)

Shprehur në 000/lek

Nr. i artikullit	Emertimi i artikullit	Plan vjetor 000/lek	Fakti	Diferenca		
602 01	Kancelari	3	x	3		
602. 02	Udhëtim e dieta	8	8	x		
	Kurthe për monitorim	12	12	x		
	Pesticide për spërkatje	27	27	x		
	Totali	50	47	3		

Drejtuesi i projektit
Mendim Bacaj
Ramo Merkohitaj

Përgj. Financës
Luljeta Malaj

TITULLARI
Dr Aulona Veizi